



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2022, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arif Dermishit.
- II. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, ka këto karakteristika:
 1. Pjesa e parcelës kadastrale, nr. 01211-0, me sip. 122 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01211-0, Zona kadastrale Prishtinë, pjesa e parcelës kadastrale nr. 02408-0, me sip. 148 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-02408-0, Zona kadastrale Prishtinë dhe pjesa e parcelës kadastrale nr. 02409-0, me sip. 257 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-02409-0, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Arif (Ali) Dermishit me destinim rrugë e planifikuar sipas Planit rregullues të hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, i miratuar me Vendimin, nr. 01 nr. 031-247790, të dt. 04.10.2016.
 2. Ndërsa prona e paluajtshme që do të jepet në këtë këmbim, është parcela kadastrale nr. 00574-0, me sip. 500 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00574-0, Zona kadastrale, Matiçan, në pronësi, pronë shoqërore - rrugë publike të pakategorizuar, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin, nr. 01, nr. 35-14451, të dt. 21.06.2005, Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01 nr. 35-64, të dt. 01.04.2010, dhe PZHU-së me nr. 01 nr. 031-156871, të dt. 27.08.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", në Prishtinë.
- IV. Pas shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/06-277158/22, më 29.12.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02-178280/22, dt. 16.08.2022 dhe Ndryshim Plotesimi i Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02-178280/22, dt.05.10.2022, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr.574-0, sip.500m², Z.K Matiçan në pronësi të P.Sh Rrugë Publike e të Pakategorizuar, e cila gjendet në kuadër të bllokut urban “B-3” Tërësia “B”, planit rregullues “Mati 1”, i miratuar me vendimin nr. nr.01nr.35-14451, dt.21.06.2005, Vendimit per Plotesim dhe Ndryshim i planit rregullues “Mati 1” i miratuar me vendimin nr. nr.01nr.35-642, dt.01.04.2010 dhe PZHU-se me nr. 01nr.031-156871, dt.27.08.2013, dhe pjesën e parcelave me nr. 1211-0, me sip. 122m², 2408-0, me sip. 148m² dhe 2409-0, me sip. 257m², Z.K Prishtinë, në pronësi të Arif (Ali) Dermishi me destinim rrugë të planifikuar.

Vendimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02-178280/22, dt. 16.08.2022, Ndryshim Plotesimi i Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02-178280/22, dt.05.10.2022. Parcela me nr.574-0, Zona Kadastrale Matiçan shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa pjesët e parcelave me nr. 1211-0, me sip. 122m², 2408-0, me sip. 148m² dhe 2409-0, me sip. 257m², Z.K Prishtinë, sipas planit rregullues të hollësishëm “Sofalia” 2016-2024, i miratuar me vendimin nr. nr.01nr.031-247790, dt.04.10.2016, Prishtinë, shtrihen në infrastrukturë publike-rrugë të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij Vendimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.